DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 26 mars 2026

V L E R Ë S I M

Lënda: **Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin "Për mbylljen e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim"**

Vlerësimi i përgjithshëm: 79/100 **Përgjithësisht pozitiv**

A) ***Informacione të përgjithshme mbi procesin***

Emërtimi i propozimit të politikës	Projektligji "Për mbylljen e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim"
Ministria udhëheqëse	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Numri/data e RIAs	2026 – MEI – Nr.7
Statusi	Final
Data e marrjes për shqyrtim	4 mars 2026
Data e komenteve të fundit	17 mars 2026
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	36/34
Numri i ripunimeve	3

A) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është sigurimi i një procesi efikas dhe eficent likuidimi për shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, duke synuar finalizimin e procedurave të tejzgjatura të likuidimit, zhbllokimin e aseteve që aktualisht janë të pashfrytëzuara dhe të bllokuara për shkak të mosfinalizimit të procesit likuidues dhe rivitalizimin e ekonomisë duke siguruar kushtet për pëdorimin produktiv të pasurive publike në përputhje me interesin publik.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë të detajuar.

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë ***plotësisht*** në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të jepet një informacion më konkret mbi punën e kryer gjatë viteve për të limituar ose shmangur problemet e konstatuara për procesin e likuidimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror.
2. Të kryhet një analizë e detajuar sasiore për secilin nga grupet e prekura, duke përshkruar dhe monetizuar qartë kostot dhe përfitimet që rrjedhin nga ndërhyrja ligjore. Të plotësohet tabela e shtojcës 2/a dhe 2/b.
3. Të listohen risitë konkrete të projektligjit, në rubrikën e arsyetimit të opsionit të preferuar, duke shmangur listimin në mënyrë të përgjithshme dhe përsëritëse të avantazheve të nismës.
4. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.